

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DronesVision Albania” SHPK

Ortaku themelues si më poshtë:

- **Z. Rogert Huqi**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 13.07.1978, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, rruga “Mine Peza”, pallati 130, hyrja 3, mbajtës dokumentit të identifikimit bashkëlidhur këtij akti themelimi,

bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 03.09.2025, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “DronesVision Albania”.
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “DronesVision Albania”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “DronesVision Albania” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën rruga “Koli Bano”, Pall. nr. 21, kati 1-rë, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën e:

- Montim, instalim prodhim, mirëmbajtje, eksport–import të dronëve, pajisje te levizshme pa pilot, ushtarakë dhe civilë, si dhe të pajisjeve të tjera teknologjike në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe survejimit.
- Projektim, zhvillim dhe inovacion teknologjik në fushën e dronëve, pajisje te levizshme pa pilot, elektronikës, sistemeve të automatizuara dhe inteligjencës artificiale (IA).
- Trajnim dhe certifikim profesional për përdorimin, mirëmbajtjen dhe pilotimin e dronëve dhe sistemeve të ngjashme.
- Shërbime inxhinierike, software dhe IT, përfshirë zhvillimin e aplikacioneve të kontrollit të dronëve, pajisje te levizshme pa pilot, sistemeve të mbikëqyrjes dhe platformave digjitale.

- Shërbime këshillimore dhe konsulencë në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe teknologjisë ajrore.
- Qendër kërkimi dhe zhvillimi (R&D) për teknologji të reja në industrinë e mbrojtjes dhe të sigurisë.
- Prodhim dhe integrim të pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë për dronë, pajisje të levizshme pa pilot, dhe sisteme të lidhura.
- Aktivitete partneriteti dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, përfshirë transferimin e teknologjisë dhe prodhimin lokal.
- Shitje dhe blerje me shumicë e pakicë të dronëve, pajisjeve teknologjike dhe produkteve të lidhura, në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.
- Projektimi, prodhimi, riparimi, asgjësimi dhe tregtimi brenda dhe jashtë vendit të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë dhe armët ushtarake, municioneve, teknologjitë dhe pajisjet ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari

Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera, vendase apo të huaja, publike apo private, për përmbushjen e objektit të aktivitetit të saj.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "DronesVision Albania" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortaku/ët nuk përgjigjet/n për detyrimet e shoqërisë "DronesVision Albania" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "DronesVision Albania" SHPK është 1,000,000 (një milion) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku i vetëm Rogert Huqi, i cili zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 1,000,000 (një milion) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % (njëqind përqind) në kapitalin e shoqërisë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme

- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë do të jetë ortak i vetëm Rogert Huqi.

NENI 11

Sekreti tregtar

Ortaku/ët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "DronesVision Albania" SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

ROGERT HUQI

